

## **KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH**

Kjo kontratë shitblerje kuotash nënshkruhet sot më datë 22/07/2020, nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

- **Z. Besnik Leskaj**, shtetas shqiptar, i biri i Astritit, lindur më 30/06/1976, në Tiranë dhe banues në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa 68, Hyrja 10, Apartamenti 12, Njësia Bashkiake Nr. 5, 1019, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit ID Nr. 033356215 dhe Nr. personal H60630112W, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, *dhe*
- **Z. Redjan Basha**, shtetas shqiptar, i biri i Nylbiut, lindur më datë 08 Mars 1984 në Gjirokastër dhe banues në adresën: Blv. Gjergj Fishta, Kulla Nr. 5, Kati Nr. 13, Ap. 65, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit ID Nr. 033522709 dhe Nr. personal I40308092C, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar; (të dy së bashku këtej e tutje referuar si "**Shitësit**");

**nga njëra anë**

*dhe*

- **Z. Fation Veizaj**, shtetas shqiptar, i biri i Sulo, lindur më 18.09.1966 në Vlorë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal G60918033, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (këtëj e tutje referuar si "**Blerësi**").

**nga ana tjetër**

(këtej e tutje Shitësit dhe Blerësi referohen bashkarisht edhe si "*Palët*" dhe veçmas si "*Pala*")

***\*\*Kushtet paraprake\*\****

- A) Shitësi Z. Besnik Leskaj është ortak dhe zotëron një kuotë e përbërë nga 30% (tridhjetë përqind), me vlerë nominale 630,000 Lekë (gjashtëqind e tridhjetë mijë lekë) të kapitalit të Shoqërisë **INTER.TEK WESTERN BALKANS SH.P.K.**, shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 24/01/2018, me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Themistokli Gërmenji", Pallati përballë RTSH, Kati Përdhe, Tiranë, Shqipëri, pajisur me numër unik identifikimi NUIS L81324046T (këtu e në vijim referuar si "**Shoqëria**").
- B) Shitësi Z. Redjan Basha është ortak në Shoqëri dhe zotëron 1 (një) kuotë e përbërë nga 30% (tridhjetë përqind), me vlerë nominale 630,000 Lekë (gjashtëqind e tridhjetë mijë lekë) të kapitalit të Shoqërisë.
- C) Blerësi është ortak në Shoqëri dhe zotëron 1 (një) kuotë e përbërë nga 40% (dyzetë përqind), me vlerë nominale 840,000 Lekë (tetëqind e dyzetë mijë lekë) të kapitalit të Shoqërisë.
- D) Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësit dhe Shitësit dëshirojnë të shesin kuotat që Shitësit disponojnë dhe zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë, të barabarta me 60% (gjashtëdhjetë

përqind), me vlerën nominale prej **1,260,000 Lekë** (një milionë e dyqind e gashtëdhjetë mijë lekë) të kapitalit të Shoqërisë.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët pranojnë të lidhin këtë Kontratë Shitblerje Kuotash (këtë e tutje referuar si “**Kontrata**”) sipas kushteve të mëposhtme:

**Neni 1**  
**Kushtet paraprake**

Kushtet paraprake të mësipërme përbëjnë pjesë përbërëse dhe thelbësore të Kontratës.

**Neni 2**  
**Shitia e kuotave**

- 2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësit shesin dhe transferojnë kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë, të barabarta me 60% (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë (këtë e tutje referuar si “Kuotat”), të lira nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili pranon dhe i blen ato.
- 2.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi në përputhje dhe në proporcion me Kuotat e blera, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet të saj sipas kushteve të rëna dakord, dhe në veçanti të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e Shoqërisë duke filluar nga viti ushtrimor në vazhdim, për të ndarë pasurinë e Shoqërisë si dhe merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme.
- 2.3. Me transferimin e Kuotave sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga 1 (një) kuotë, që do të jetë në pronësi të Blerësit Z. Fation Veizaj, i cili do të zotërojë 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me vlerë nominale 2,100,000 Lekë (dy milionë e njëqind mijë lekë), në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

**Neni 3**  
**Çmimi**

- 3.1 Çmimi i Shitjes për blerjen e Kuotës së Shitësit Z. Besnik Leskaj nga Blerësi do të jetë në vlerë të barabartë me vlerën nominale prej **630,000 Lekë** (gjashtëqind e tridhjetë mijë lekë), siç përcaktohet edhe në kushtet paraprake, çmim i cili do të paguhet nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, në llogarinë bankare të Shitësit Z. Besnik Leskaj.
- 3.2 Çmimi i Shitjes për blerjen e Kuotës së Shitësit Z. Redjan Basha nga Blerësi do të jetë nc vlerë të barabartë me vlerën nominale prej **630,000 Lekë** (gjashtëqind e tridhjetë mijë lekë), siç përcaktohet edhe në kushtet paraprake, çmim i cili do të paguhet nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, në llogarinë bankare të Shitësit Z. Redjan Basha.

- 3.3 Shitësit bien dakord me Çmimin e Shitjes së parashikuar sipas përcaktimeve të këtij seksioni dhe konfirmojnë se Blerësi nuk ka asnjë detyrim tjetër kundrejt Shitësve për Çmimin e Shitjes pasi pagesa të jetë kryer në përputhje me kushtet e mësipërme në llogaritë bankare të vëna në dispozicion nga Shitësit.
- 3.4 Të gjitha pagesat dhe detyrimet e mundshme sipas parashikimeve të kësaj Kontrate do të jenë në Lekë.

#### **Neni 4 Transferimi i Kuotave**

- 4.1 Titulli i Kuotave do t'i transferohet Blerësit dhe Kuotat do të shiten dhe do të blihen së bashku me të gjitha të drejtat, përfitimet dhe detyrimet që i bashkangjiten Kuotave osc që rrjedhin nga ato në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 4.2 Palët do të nënshkruajnë dhe do të sigurojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e rregullt të transferimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### **Neni 5 Deklarime dhe Garanci të Shitësit**

- 5.1 Shitësit garantojnë Blerësin se janë personat e vetëm legitim përmarrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- 5.2 Shitësit garantojnë Blerësin se Kuotat objekt i kësaj Kontratë janë të lira nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 5.3 Në momentin që nënshkruhet kjo Kontratë, pala shitëse deklaron se nuk ka asnjë pretendim pronësie përmarrët e Kuotat që shet dhe asnjë formë tjetër të mundshme pretendimi nga ana e vetë Shoqërisë.
- 5.4 Shitësit njojin të gjitha detyrimet e tillë që kanë rënduar mbi Shoqërinë në tërësi dhe mbajnë përgjegjësi mbi pasojat ligjore të administrimit të deritanishëm.
- 5.5 Blerësi deklaron se njeh gjendjen e faktit dhe të drejtës në të cilën ndodhet Shoqëria në momentin e blerjes së Kuotave, dhe se i çliron Shitësit nga çdo lloj pasivi të Shoqërisë, si aktual ashtu dhe potencial, që ekziston deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, në lidhje me Kuotat e Shoqërisë të cilat transferohen tek Blerësi.

#### **Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve me diskutim të drejtpërdrejtë midis tyre.
- 6.2 Nëse nuk arrihet që një mosmarrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhja do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 7  
Ligji i zbatueshëm**

Kjo Kontratë regullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Palëve.

**Neni 8  
Përbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet**

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

**Neni 9  
Konfidencialiteti**

- 9.1 Asnjëra prej Palëve nuk duhet të zbulojë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër tek ndonjë person, apo të bëjë një njoftim publik në lidhje me informacionet që prekin dispozitat e kësaj Kontrate dhe/ose transaksionit objekt i saj.
- 9.2 Kur njëra nga Palët vendos në mënyrë të arsyeshme se zbulimi ose njoftimi i informacionit të përmendur më sipër kërkohet në bazë të ligjit, rregulloreve ose çdo autoriteti tjetër të cilit njëra Palë i nënshtronhet, ky zbulim osc njoftim i informacionit, për aq sa lejon ligji, nëse është e mundur në mënyrë të arsyeshme, do të kryhet pas konsultimit me Palën tjetër.

**Neni 10  
Origjinalët**

Kjo kontratë është lidhur në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Kjo Kontratë nënshkruhet nga Palët në Tiranë, më datë 22 Korrik 2020.

\* \* \*

**Shitësi**

Besnik Leskaj  
Z. Besnik Leskaj

**Blerësi**

Faton Veizaj  
Z. Faton Veizaj

Redjan Basha  
Z. Redjan Basha